**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

---

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**
14-353/02-36698/24, më 13 MAR 2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008 dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

**V E N D I M**

**I.** Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike që në raste të caktuara të lejohet vendosja e laurave për shkaqe të sigurisë në disa objekte për institucionet e ndryshme si: Prokuroria e Shtetit, gjykatat, policia, institucionet tjera të sigurisë, institucionet shëndetësore, institucionet bankare dhe ato mikro financiare si dhe institucione të ngjashme.

**II.** Kërkesat për vendosjen e laurave sipas pikës 1. të këtij vendimi parashtrohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

**III.** Kërkesat shqyrtohen nga drejtoritë përkatëse të përcaktuara me këtë vendim dhe pas vlerësimit të tyre dhe gjendjes në terren, vendosin që të japin pëlqim për vendosjen e laurës ose refuzimin e kërkesës si të pabazuar.

**IV.** Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHET:**

- **Drejtorisë së Shërbimeve Publike;**
- **Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe**
- **Në dosje.**

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**
**Përparim Rama**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E PRISHTINËS – KABINETI I KRYETARIT – REPUBLIKA KOSOVA – OPŠTINA PRIŠTINA – KABINET PREDSEDNIKA